

RELACION **MBI PROJEKTVENDIMIN**

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT", TË NDRYSHUAR.

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Këto rregullime vijnë si rezultat i problematikave të ndryshme që janë hasur në praktikë, gjatë implementimit të vendimit aktual, si dhe përshtatjes së tij me ndryshimet e fundit në Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar. Ky projektpropozim saktëson rastet kur subjektet zhvilluese pavarësisht procedurave të plota të kryera nga AZHT, refuzojnë të paguajnë tarifën përkatëse për marrjen e lejeve që lëshohen nga KKTU, në përputhje me VKM-në 428, datë 26.6.2024 “Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit” si dhe rastet e ndërtimit në faqe kallkan.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRATVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektakti është në përputhje me programin e analitik të hartimit të akteve nënligjore për vitin përkatës, si dhe me objektivat strategjike për menaxhimin efektiv të zhvillimit dhe planifikimit të territorit. Ky projektakt kontribuon edhe në

mirëfunksionimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit si Sekretariat i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit si dhe përmirësimin e shërbimeve publike nëpërmjet sistemit e-leje, gjatë shqyrtimit të aplikimeve kompetencë e KKTU-së.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektakti adreson problematika të hasura gjatë zbatimit të Rregullores së Zhvillimit të Territorit nga ana e sekretariatit të KKTU-së për lejet në kompetencë e saj:

- Mungesën e procedurës në rastet e mos-pagesës së tarifave duke u shtuar dispozita të qarta në nenet 10/2, 13/1, 17, 17/1, 18 dhe 27 të rregullores, ku përcaktohet se në mungesë të pagesës së tarifës brenda afatit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, Sekretariati i KKTU-së ka të drejtë të refuzojë aplikimin përkatës.
- Formalizimi i procedurës së ndryshimit të subjektit zhvillues, i cili tashmë ekziston në sistemin e-leje, por ka lindur nevoja të përcaktohet qartë edhe dokumentacioni që duhet të plotësohet nga zhvilluesi dhe përfituesi i të drejtës së zhvillimit, përmes shtimit të nenit 13/1.
- Qartësimi i rregullave për ndërtimet me faqe kallkan, duke bërë të mundur zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe lehtësimin e procedurave në rastet e mbushjes urbane, në përputhje me Nenin 34, pika 6 të rregullores.
- Saktësimin e distancave në rastet e miratimeve në kompetencë të KKTU, në përputhje me rregulloren e veçantë, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 28 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
- Ndalimi i dhënies së lejeve të ndërtimit, si dhe kryerja e çdo lloj punimi, për vendosjen e rrethimeve, trarëve, ose çdo mjeti kufizues të hyrjes në ato prona private, apo pjesë të sipërfaqes së tyre, të cilat janë të ngarkuara me servitut publik në kuptim të nenit 34 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar. Pavarësisht nëse nuk është regjistruar servituti në regjistrin e pasurive të paluajtshme, të njëjtat leje dhe punime nuk lejohen as në ato prona private, apo pjesë të sipërfaqes së tyre, në zonat

urbane, të cilat plotësojnë kushtet ligjore për të qenë të ngarkuara me servitut publik, të tilla si: prona që përbëjnë rrugën e daljes nga objektet drejt hapësirave publike, rrugët e kalimit ndërmjet objekteve, apo nga objektet drejt rrugëve dhe shesheve publike, etj.”

- Shtimin e kompetences për KKTU për të gjitha objektet mbi 5 kate.

Këto ndërhyrje synojnë përmirësimin e efikasitetit institucional, sigurimin e të ardhurave nga tarifa sipas afateve të përcaktuar në këtë rregullore, si dhe garantimin e sigurisë juridike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTËTUSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.107/2014, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Përmbajtja e tij është në harmoni me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, dhe legjislacionin sektorial.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ASQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk përafron akte me acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti përmban 11 nene që sjellin të cilat sjellin këto shtesa dhe ndryshime:

Relation shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar””.

- Në Nenin 1 përcaktohet ndryshimi i pikës 10/7 të Nenit 2 “Përkufizime” të VKM-së “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, me përmbajtjen si më poshtë vijon:
“10/7. “Projekt TIP” janë projektet e hartuara dhe të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për qëllime strehimi dhe banimi në zonat rurale në përputhje me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit në fuqi .”
- Në Nenin 2 përcaktohet shtimi i pikës 9 pas pikës 8 të Nenit 10/2 të VKM-së “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”e ndryshuar me përmbajtjen si më poshtë:
“9. Sekretariati lëshon dokumentin e refuzimit të lejes së zhvillimit, në rast se subjekti kërkues nuk kryen pagesën e tarifës për leje zhvillimi, brenda 15 ditëve, nga marrja e njoftimit për lëshimin e faturës nga sekretariati.”
- Në Nenin 3 përcaktohet shfuqizimi i togfjalëshit “të miratuara nga autoriteti vendor” në gërmën “d” të pikës 1 të Nenit 11 “Punime për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi”.
- Në Nenin 4 përcaktohet ndryshimi i pikës 2 të Nenit 11/3 me përmbajtjen si më poshtë vijon:
“2. Autoriteti vendor i zhvillimit të territorit miraton lejet e ndërtimit për projektet TIP për objekte njëfamiljare.”
- Në Nenin 5 përcaktohet ndryshimi i pikës 2 të Nenit 13 si më poshtë vijon:
“2. Leja e ndërtimit është e transferueshme, me ndryshimin e subjektit përfitues të lejes së ndërtimit, dhe kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen me kërkesën e subjektit zhvillues ose të subjektit përfitues.”
- Në Nenin 13 shtohet Neni 13/1 “për ndryshimin e subjektit zhvillues” me përmbajtjen si vijon:

“1. Subjekti zhvillues, si dhe subjekti përfitues mund të kërkojnë pranë autoritetit që ka miratuar lejen e ndërtimit, në sistemin e-leje, ndryshimin e subjektit zhvillues të lejes së ndërtimit.

2. Dokumentacioni, që duhet të dorëzojë kërkuesi për ndryshimin e subjektit zhvillues është, si më poshtë vijon:

a) prokura ose autorizimi, në emër të personit fizik apo juridik, në rast se kërkesa paraqitet nga një përfaqësues i zhvilluesit;

b) marrëveshja mbi kalimin e të drejtavë të zhvillimit sipas lejes së miratuar midis subjektit zhvillues dhe subjektit përfitues;

c) dakordësi/ marrëveshje të pronarit/ëve të pronës/ave, që marrin pjesë në zhvillim mbi kalimin e të drejtave të zhvillimit nga subjekti zhvillues tek subjektit përfitues;

d) tarifa e aplikimit sipas legjislacionit në fuqi.

3. Për rastet në kompetencë të KKTU, sekretariati lëshon refuzimin e ndryshimit të subjektit zhvillues, në rast se kërkuesi nuk kryen pagesën e tarifës përkatëse, brenda 15 ditëve, nga marrja e njoftimit për lëshimin e faturës nga sekretariati.”

Në nenin 7, i cili shton pikën 5 dhe pikën 6 në nenin 14 të vendimit ne fuqi, shtohet përmbajtja si më poshtë vijon:

“5. Ndalohet dhënia e lejeve të ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit, për pasuritë private të cilat kanë qënë pjesë e kufirit të zhvillimit dhe të destinuara për hapësira publike si: sheshe, parqe, etj.”

“6. Ndalohet dhënia e lejeve të ndërtimit, si dhe kryerja e çdo lloj punimi, për vendosjen e rrethimeve, trarëve, ose çdo mjeti kufizues të hyrjes në ato prona private, apo pjesë të sipërfaqes së tyre, të cilat janë të ngarkuara me servitut publik në kuptim të nenit 34 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar. Pavarësisht nëse nuk është regjistruar servituti në regjistrin e pasurive të paluajtshme, të njëjtat leje dhe punime nuk lejohen as në ato prona private, apo pjesë të sipërfaqes së tyre, në zonat urbane, të cilat plotësojnë kushtet ligjore për të qenë të ngarkuara me servitut publik, të tilla si: prona që përbëjnë rrugën e daljes nga

objektet drejt hapësirave publike, rrugët e kalimit ndërmjet objekteve, apo nga objektet drejt rrugëve dhe shesheve publike, etj.”

- Shtesat janë kryer edhe në nenet 17, 17/1 dhe 18 të cilat kanë lidhje me refuzimin e kërkesës për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, shtyrjen e afatit si dhe rishikimin e kushteve për shkak të mos kryerjes së pagesave të tarifave përkatëse, të cilët janë pasqyruar në Nenet 3, 4 dhe 5 të këtij projektvendimi me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Neni 8

Në nenin 17 pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“4. Për rastet në kompetencë të KKTU, sekretariati lëshon refuzimin e ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit, në rast se subjekti kërkuar nuk kryen pagesën e tarifës përkatëse, brenda 15 ditëve, nga marrja e njoftimit për lëshimin e faturës nga sekretariati.”

Neni 9

Në nenin 17/1 pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“2. Për rastet në kompetencë të KKTU, sekretariati lëshon refuzimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit, në rast se subjekti kërkuar nuk kryen pagesën e tarifës përkatëse, brenda 15 ditëve, nga marrja e njoftimit për lëshimin e faturës nga sekretariati.”

Neni 10

Në nenin 18 pas pikës së parë shtohet pika 2 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“2. Për rastet në kompetencë të KKTU, sekretariati lëshon refuzimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit, në rast se subjekti kërkuar nuk kryen pagesën e tarifës përkatëse, brenda 15 ditëve, nga marrja e njoftimit për lëshimin e faturës nga sekretariati.”

Neni 11 ndryshon nenin 19 dhe përkatësisht:

Në Nenin 19, gërma “ç” e pikës 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“ç) Veprat e infrastrukturës apo/dhe objektet ndërtimore, pavarësisht kushteve dhe kriterëve të zhvillimit, kur shtrihen brenda zonës së brezit bregdetar, si dhe çdo objekt mbi 5 kate, kur shtrihen jashtë kësaj zone.

Neni 12 ndryshon nenin 25 dhe përkatësisht:

- Pas pikës 10 shtohet pika 10/1 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“10/1. Pas konfirmimit të Vendimit të KKTU-së njoftohet kërkuesi nga sekretariati i KKTU-së, për të kryer pagesën e tarifës për shqyrtimin e kërkesës për leje ndërtimi brenda 90 ditëve nga lëshimi i faturës së arkëtimit nga sekretariati.”

- Pika 11 nryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“11. Pasi paguhet tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje ndërtimi, nëpërmjet sistemit elektronik të lejes, kërkuesi duhet të ngarkojë dokumentin që provon pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, si dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara në vendim, në rastin e vendimit të miratimit me kusht, brenda 90 ditëve nga marrja e njoftimit në sistemin e-leje.”

- Saktësime janë bërë edhe në Nenin 27 me përmbajtjen si vijon:

“Përmbajtja e fjalisë së parë të pikës 1 zëvendësohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Në përfundim të procesit të zhvillimit kërkuesi paraqet kërkesën për t’u pajisur me certifikatë përdorimi, së bashku me procesverbalin e kolaudimit dhe dokumentacionin shoqërues, përfshirë deklaratën teknike se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi, pranë autoritetit të zhvillimit që ka miratuar lejen e ndërtimit.

Pas pikës 9 shtohet pika 10 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“10. Për certifikatat e përdorimit që lëshohen nga KKTU, sekretariati lëshon refuzimin e certifikatës së përdorimit, në rast se subjekti kërkues nuk kryen pagesën e tarifës përkatëse, brenda 15 ditëve, nga marrja e njoftimit për lëshimin e faturës nga sekretariati.”

- Ndryshime janë kryer edhe në Nenin 34 “Distancat minimale midis ndërtimeve”, ku në pikën 6 të këtij neni shtohen paragrafët me përmbajtjen:

“6.... Në situatat ekzistuese, në rast se objekti ekzistues ka faqe kallkan, mund të vijohet me ndërtimin nga kufitari me faqe kallkan deri në kufi të pronës, pa patur nevojë për marrëveshje mes palëve.

Për objektet në kompetencë të KKTU-së, vetëm në rastet e mbushjes urbane, objekti ndërtohet me faqe kallkan deri në lartësinë e objekteve që kanë faqe kallkan, të cilave ju bashkëngjitet si dhe duke respektuar lartësinë e parashikuar në planin e përgjithshëm vendor në fuqi.”

- Në Nenin 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:

“Objektet në kompetencë të KKTU-së, të cilat miratohen me rregullore të veçantë përjashtohen nga parashikimi i pikës 1 të këtij neni, në rastet kur kufitar është pronari shtet.”

- Gjithashtu shtohet Dispozita kalimtare me përmbajtje si më poshtë vijon:

“1. Ngarkohen autoritetet e zhvillimit të territorit për të rishikuar anulimin e plotë ose të pjesshëm të deklaratave paraprake apo lejeve të ndërtimit për rrethime, apo çdo lloj pengese hyrjeje në pronat private, të cilat që në kohën e miratimit të tyre kanë qenë të ngarkuara me servitut publik në kuptim të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, ose që edhe nëse nuk kanë servitut të regjistruar, vijnë të përmbushin të gjitha kushtet ligjore për të qenë të ngarkuara me servitut publik, të tilla si : prona që përbëjnë rrugën e daljes nga objektet drejt hapësirave publike, rrugët e kalimit ndërmjet objekteve, apo nga objektet drejt rrugëve dhe shesheve publike, etj.

Në rast se kushtet ligjore të servitutit publik dhe pengimi i aksesit në hapësirat publike, kanë lindur pas dhënies së deklaratës paraprake apo lejes së ndërtimit për rrethim, atëherë lejet i nënshtrohen shfuqizimit, të plotë ose të pjesshëm, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Procedura e shfuqizimit nis ose kryesisht nga bashkitë, në bazë të inspektimeve të kryera nga strukturat e kontrollit të zhvillimeve në territor, ose me ankesë të palëve të interesuara.

2. Ndalohej dhënia e deklaratave paraprake për vendosjen e rrethimeve, trarëve, ose çdo mjeti kufizues të hyrjes në ato prona private, apo pjesë të sipërfaqes së tyre, për të cilat ka aplikim për vendimmarrje për leje zhvillimi apo leje ndërtimi pranë KKTU.”

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të miratojnë projektet TIP, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij akti janë: Agjencia e Zhvillimit të Territorit në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit si dhe autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, që sipas legjislacionit sektorial duhet të shprehen mbi kërkesat për leje ndërtimi.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është përgatitur dhe propozuar për miratim në Këshillin e Ministrave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektvendimi u dërgua për mendim nëpërmjet sistemit e-akte, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave, me anë të shkresës së përcjellë me anë të sistemit e-aktet, shprehet parimisht dakord për sa kohë ndryshimet e parashikuara kanë karakter procedural dhe nuk shoqërohen me kosto për buxhetin e shtetit.

Ministria e Drejtësisë, me anë të shkresës së përcjellë me anë të sistemit e-aktet, shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të nenit 13/1 që synohet të shtohet përmes nenit 2 të projektaktit, parashikohet se subjekti zhvillues, si dhe subjekti përfitues mund të kërkojnë pranë autoritetit që ka miratuar lejen e ndërtimit, në sistemin e-leje, ndryshimin e subjektit zhvillues të lejes së ndërtimit, ndërkohë që në pikën 2, të nenit 13 të rregullores për zhvillimin e territorit, miratuar me VKM-në nr. 408/2015, të ndryshuar, parashikon se leja e ndërtimit është e transferueshme, me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi. Pra, ndryshimi i subjektit zhvillues mund të kërkohej vetëm me kërkesë të subjektit i cili ka përfituar lejen e ndërtimit dhe jo subjektit i cili synohet të jetë përfitues i mundshëm. Rrjedhimisht, sugjerojmë sigurimin e koherencës ndërmjet dispozitave. Gjithashtu, në pikën 2 të po këtij neni sugjerojmë të përcaktohet referenca konkrete në legjislacionin në fuqi i cili përcakton tarifat përkatëse të aplikimit, me qëllim sigurimin e qartësisë dhe shmangien e paqartësive në zbatim.

Ky koment është reflektuar duke shtuar nenin 5, ku ndryshohet pika 2, e nenit 13.

2. Sa i përket ndryshimeve të nenit 25, që synohet të kryhen përmes nenit 8 të projektaktit, vlerësojmë se është e paqartë mënyra e formulimit të dispozitës duke krijuar paqartësi në përlllogaritjen e afateve për kryerjen e pagesës. Në këto kushte, sugjerojmë rishikimin e saj.

Ky sugjerim nuk është reflektuar, e cila i referohet ndryshimit të nenit 25, të cilin propozuesi sugjeron të qëndrojë e pandryshuar pasi është e rëndësishme të ndahen momenti i pagesës së tarifës së shërbimit, nga momenti i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë. Ndryshimi është propozuar për të përshtatur kuadrin ligjor pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 428, datë 26.06.2024, si dhe në sistemin e-leje.

3. Në lidhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 12 të projektaktit sjellim në vëmendje se rastet e anulimit dhe shfuqizimit të akteve administrative dhe pasojat që sjellin përcaktohen në mënyrë shteruese nga Kodi i Procedurave Administrative. Rrjedhimisht, nëse shkak i paligjshmërisë ka lindur pas dhënies së deklaratës paraprake apo lejes së ndërtimit, nuk mund të vijohet me anulimin e aktit administrativ të ligjshëm, por vetëm me shfuqizimin e tij. Në këto kushte, sugjerojmë rishikimin e dispozitës.

Ky koment është rëfektuar dhe është ripunuar pika 1 e neni 16 , të projektvendimit.

4. Në zbatim të rregullave të teknikës legislative sugjerojmë të shtohet një dispozitë e cila të përcaktojë organet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektakti. Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj parashikimet e nenit 36 të udhëzimit nr.6, datë 29.4.2022 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, mbi dispozitën hyrëse në aktet ndryshuese, si dhe të tregohet në dispozitën hyrëse fakti se krahas shtesave synohen të bëhen dhe ndryshime në aktin përkatës.

Ky koment është rëfektuar duke shtuar nenin 17, të projektvendimit.

Gjithashtu edhe nga ana e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit janë bërë sugjerime në lidhje me ndryshimet e propozuara në VKM-në 408, të cilat gjithashtu janë rëfektuar në projektvendim. Këto sugjerime konsistojnë në ndryshimet si më poshtë vijon:

“Në nenin 4 të projektvendimit, i cili ndryshon nenin 17 të VKM nr.408/2015, të shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“5.Në çdo rast të ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit, kërkuesi duhet të ngarkojë në sistemin e-leje një deklaratë të përbashkët ndërmjet zhvilluesit dhe projektuesit arkitekt, në të cilën këto palë pranojnë dhe konfirmojnë ndryshimet në projekt”

Në nenin 12 “Dispozitë kalimtare” të projektvendimit, të shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë vijon:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar””.

“3.Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të miratojë projektet TIP, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.”

*Në nenin 2 “Përkufizime”, pika 10/7 ndryshohet si më poshtë vijon:
“10/7. “Projekt TIP” janë projektet e hartuara dhe të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit përkatës për qëllime strehimi dhe banimi në zonat rurale në përputhje me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit në fuqi .”*

Në nenin 11 “Punime për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi”, gërma “d” e pikës 1 shfuqizohet togfjalshi “të miratuara nga autoriteti vendor”

*Në nenin 11/3 “Procedura e thjeshtuar për pajisjen me leje ndërtimi për objektet njëfamiljare në zonat rurale”, pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:
“2.Autoriteti vendor i zhvillimit të territorit miraton lejet e ndërtimit për projektet TIP për objekte njëfamiljare.”*

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektvendimi nuk ka efekte shtesë për Buxhetin e Shtetit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE
MINISTËR**

BELINDA BALLUKU